

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, sipas gjyqtarit Adem Shabani, me procesmbajtësën-praktikanten Shkëlqesa Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.T. nga fshati ....., komuna e Kaçanikut, për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së dhe vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.8-4/14 dt.04.07.2014, PP/II.nr.2553-4/14 dt.18.03.2015, PP/II.nr.158-1/15 dt.16.09.2015 dhe PP/II.nr.1894-8/14 dt.30.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.18.08.2016, në prani të përfaqësuesit të aktakuzave - prokurorit të shtetit Veton Shabani dhe të akuzuarit Sh.T., të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **SH.T.** nga fshati ....., komuna e Kaçanikut, i data e lindjes...., nga i ati I. dhe e ëma Sh., e gjinisë N., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTORË**

**SEPSE:**

**I.**

1.Me datë 11.12.2013, rreth orës 12:30, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për zhvillim ekonomike-njesia e pylltarisë Shtërpçë në rajonin ekonomik pyjorë Brod në vendin e quajtur ‘Paralelja 3’ me qëllim vjedhje ka prerë 3 drunj të llojit ahu me diametër 30-32cm, lartësi prej 14-20m, gjithsejtë në kubaturë prej 2,17m.kubë, vlera e dëmit të shkaktuar është 292,95€.

2.Me datë 31.12.2013, rreth orës 14:25, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për zhvillim ekonomike-njesia e pylltarisë Shtërpçë në rajonin ekonomik pyjorë Brod në vendin e quajtur ‘Paralelja 2’ me qëllim vjedhje ka prerë 6 drunj të llojit ahu me diametër 30-61cm, lartësi prej 19-23m, gjithsejtë në kubaturë prej 5,74m.kubë, vlera e dëmit të shkaktuar është 774,90€.

- *me të cilën në vazhdim kreu veprën penale vjedhje pylli nga nani 358 par.2 të KPRK-së.*

**II.** Me datë 16.10.2014, rreth orës 18:00, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për zhvillim ekonomike-njesia e pylltarisë Shtërpçë në rajonin ekonomik pyjorë Brod në vendin e quajtur ‘Paralelja 7’ me qëllim vjedhje ka prerë 5 drunj të llojit ahu me diametër 35-54cm, lartësi prej 18-20m, gjithsejtë në kubaturë prej 5,69m.kubë, vlera e dëmit të shkaktuar është 768,15€.

- *me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga nani 358 par.2 të KPRK-së.*

**III.**Me datë 06.12.2014 rreth orës 13:50 në pyllin shoqëror në Njësinë Menaxhuese “L.....”, në vendin e quajtur “Brod”, me qëllim të përfitimit pasurorë në mënyr të kundërligjshme për vete apo personit tjetër, me sharrë motorike ka prerë katër copë

dru të llojit “Ahu” me gjatësi prej 16-17m, me diametër 43-30cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.60m<sup>3</sup>, e kishte ngarkuar me traktor, dhe ishte larguar nga aty, me të cilin veprim ka dëmtuar DBPZHR në Ferizaj në vlerë prej 351.00 €.

- *me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga nani 358 par.1 të KPRK-së.*

IV.Me datë 30.09.2015 në orën 16:45 në rajonin pyjor në Brod, në pyllin shtetëror, në vendin e quajtur “Paralelja nr.3”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë për vete apo personit tjetër, është takuar nga roja e pyllit duke transportuar me traktor drunjtë të pa damkosur dhe pa dokumentacion përkatës sasinë prej 2,08m<sup>3</sup>, të cilët paraprakisht me motosharrë i kishte prerë, me të cilin veprim ka dëmtuar Drejtorin për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë në vlerë prej 280,80€(Dyqindë e tetëdhjetë euro, e tetëdhjetë cent).

- *me këtë veprim ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga nani 358 par.1 të KPRK-së.*

Andaj gjykata në bazë të nenit të sipër shënuar dhe neneve 4, 7, 41, 42, 43, 45, 48 par.1 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarit

## VËRTETON

Për veprën penale në pikën I dënim me gjobë prej 300 Euro dhe burgim prej 3 muaji;

Për veprën penale në pikën II dënim me gjobë prej 200 Euro dhe burgim prej 3 muaji;

Për veprën penale në pikën **III** dënim me burgim në kohzgjatje prej **1 muaji**;

Për veprën penale në pikën **IV** dënim me burgim në kohzgjatje prej **1 muaji**;

**Konform nenit 80 par.1 të KPRK-së të akuzuarit i shqipton:**

Denim unik me gjobë në shumë prej 300 Euro të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim unik me burg në kohzgjatje prej 5 (pesë) muajve.

Gjykata në pajtim me nenin 48 par.1 të KPRK-së me pëlqimin e të dënuarit, dënimin e shqiptuar me burgim prej 5 (pesë) muajve i'a zëvendëson me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Në bazë të nenit 48 par.2 të KPRK-së dënimi i shqiptuar, me pëlqimin e dënuarit i zëvendësohet **me 240 orë (dyqindë e dyzet orë) PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME.**

Shërbimi Sprovues i Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryehet nga personii dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari si dhe ditët apo javët që i dënuari duhet të kryej punën në dobi të përgjithshme po edhe të mbikëqyrë punën në dobi të përgjithshme.

Puna në dobi të përgjithshme nga ana e të dënuarit duhet të kryhet brenda 6 (gjashtë) muajshë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i dënuari nuk e kryen punën në dobi të përgjithëshme ose të njëjtën e kryen pjesërisht, gjykata konform nenit 48 par.4 të KPRK-së do të urdhëron zbatimin e dënimit të shqiptuar me burgim, në përpjestim me punën e pakryer.

Obligohet i akuzuari që në emër të kërkesës pasurore-juridike të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë-Njësia e Pylltarisë në emër të dëmit të shkaktuar t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,467,80 €uro (dymijë e katërqindë e gjashtëdhjet e shtat €uro e tetëdhjetë cent) , të gjitha këto këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Gjithashtu obligoheti akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 € (tridhjetë €uro)**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të permbarimit të detyrueshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat P/II.nr.8-4/14 dt.04.07.2014, PP/II. nr.2553-4/14 dt.18.03.2015, PP/II.nr.158-1/15 dt.13.16.09.2015 dhe PP/II.nr.1894-8/14 dt.30.10.2015 ka ngarkuar të akuzuarin Sh.T. nga fshati ....., komuna e Kaçanikut, përshkak të veprave penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 dhe vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Gjykata kundër të akuzuari për lëndët penale që akuzohet kishte caktuar edhe më parë shqyrtim gjyqësor por i jehti nuk

i'u ishte përgjegjur ftesave dhe gjykata kishte lëshuar urdhresë policisë për sjellje me detyrim për dt.19.08.2016, e të cilin e kishin siguruar një ditë më parë ku ishte njoftuar gjyqtari gjykues dhe ju kishte thënë që ta sjellim menjëherë në gjykatë ku edhe e kishin sjellur.

Pasi ishin plotësuar kushtet ligjore gjykata me dt.18.09.2016 mbajti shqyrtimin fillestar në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Veton Shabani dhe i akuzuari Sh.T..

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqtari duke vepruar konform nenit 38 par.8 të KPPRK-së pas propozimit të prokurorit të shtetit, e sipas detyrës zyrtare bëri bashkimin e procedurave penale për lëndet penale të evidentuara pranë kësaj gjykate kundër të akuzuarit dhe atë për aktakuzat: PP/II.nr.8-4/14 dt.04.07.2014, PP/II.nr.2553-4/14 dt.18.03.2015, PP/II.nr.158-1/15 dt.13.16.09.2015, dhe PP/II.nr.1894-8/14 dt.30.10.2015 dhe për të njëjtat ka zbatuar procedurë të bashkuar pasi që në rastin konkret në të gjitha këto aktakuza është akuzuar personi i njëjti dhe për të njëjtat vepra penale.

Gjyakta pasë shiqimit të shkresave të lëndës nga fletëkthesat për dorzim personla ka vrejtur se i akuzuari nuk i ka pranuar të gjitha aktakuzat për të cilat akuzohet para fillimit të shqyrtimit fillestar i ka dorzuar nga një kopje të aktakuzave, ku i ka ofruar edhe koh për leximin e tyre.

I akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPRK-së se ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen ose të mos përgjigjet në pyetje e gjykatës, e nëse deklarohet nuk ka për detyrë të inkriminon vehten apo të afërmit e tij e as të

pranon fajësinë, të mbrohet vetë apo përmes ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij si dhe të kundërshton aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave.

Lidhur me këtë i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi të drejtat e tij mbi të cilat është udhëzuar nga gjyqtari, mbrojtës nuk do të angazhon, mbrojtjen do ta bënë vetë dhe do të përgjigjet në pyetjet e gjykatës.

Pas kësaj gjyqtari i kësaj çështje penale ka ftuar prokurorin e shtetit për të lexuar aktakuzat sipas radhës të cekura më lartë.

Pas leximit të aktakuzave veç e veç nga prokurori i shtetit prokurori për aktakuzën PP/II.nr.8-4/14 dt.04.07.2014 bën rikualifikim dhe atë për piken 1 dhe 2 ku duhet të jet se i akuzuari ka krye në vazhdim veprën penale vjedhje pylli nga nani 358 par.2 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzave i gjyqtari është bindur se i akuzuari i ka kuptuar në tërësi të drejtat e tij që i takojnë me ligj, e se i ka kuptuar edhe aktakuzat, të njëjtit i ka dhënë mundësinë të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij për veprat penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari Sh.T. për secile aktakuzë veç e veç është deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë, për veprat penale që e ka ngarkuar prokurori i shtetit sipas dateve të theksuara në aktakuza dhe në vazhdim ka theksuar se është e vërtetë se ka qenë në pyll dhe është takuar nga rojtari i pyllit por

këtë e ka bërë përshkak të gjendjes shumë të varfër ekonomike, pasi jeton vetëm me babain i cili është i moshës së vjetër dhe shumë i sëmurë dhe i duhet të kujdeset për te pasi nuk ka asnjë anëtar tjetër në familje dhe jetojnë pa asnjë të ardhur tjetër.

Ka kërkuar nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese si dhe faktin se pas vdekjes së nënës së tij ka mbetur vetëm me babain i cili është i moshës së shtyrë dhe me probleme shëndetësore e për të cilin duhet të kujdeset gjithëherë, jetojnë në kushte të vështira dhe pa asnjë të ardhur.

Pas deklarimit të të akuzuarit mbi pranimin e fajësisë për të gjitha aktakuzat për të cilat është akuzuar, gjyqtari u bind se i akuzuari i ka kuptuar në tërësi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht dhe është bazuar në faktet e çështjes që përmbajnë aktakuzat dhe në provat e prezantuara nga prokurori i shtetit, këtë edhe për arsyen se aktakuzat nuk përmbajnë ndonjë shkelje ligjore apo gabime teknik, për çka gjyqtari konsideron se pranimi i fajësisë për të gjitha veprat penale është bërë konform nenit 248 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPPRK-së dhe duke u bazuar në të njëjtin nen par.2 gjyqtari ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit Veton Shabani i cili ka deklaruar se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga i akuzuari për të gjitha veprat penale për të cilat është akuzuar pasi një pranim i tillë është bërë konform ligjit.

Gjyqtari i çështjes është bindur se janë vërtetuar të gjitha faktet mbi pranimin e fajësisë, kështu që duke u bazuar në nenin



248 par.4 të KPPRK-së ka sjellë aktvendim procedural mbi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për të gjitha veprat penale sipas aktakuzave të cekura më lartë dhe procedurën penale e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe nga provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, gjegjësisht nga kallximet penale dhe fletparaqitjet e rojtarëve të pyllit si dhe procesverbalet mbi vlerësimet e dëmit me të njëjtat numra, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me datë 11.12.2013, rreth orës 12:30, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për zhvillim ekonomike-njesia e pylltarisë Shtërpçë në rajonin ekonomik pyjorë Brod në vendin e quajtur ‘Paralelja 3’ me qëllim vjedhje ka prerë 3 drunj të llojit ahu me diametër 30-32cm, lartësi prej 14-20m, gjithsejtë në kubaturë prej 2,17m.kubë, vlera e dëmit të shkaktuar është 292,95€.

Me datë 31.12.2013, rreth orës 14:25, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për zhvillim ekonomike-njesia e pylltarisë Shtërpçë në rajonin ekonomik pyjorë Brod në vendin e quajtur ‘Paralelja 2’ me qëllim vjedhje ka prerë 6 drunj të llojit ahu me diametër 30-61cm, lartësi prej 19-23m, gjithsejtë në kubaturë prej 5,74m.kubë, vlera e dëmit të shkaktuar është 774,90€.

Me datë 16.10.2014, rreth orës 18:00, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për zhvillim ekonomike-njesia e pylltarisë Shtërpçë në rajonin ekonomik pyjorë Brod në vendin e quajtur ‘Paralelja 7’ me qëllim vjedhje ka prerë 5 drunj të llojit

ahu me diametër 35-54cm, lartësi prej 18-20m, gjithsejtë në kubaturë prej 5,69m.kubë, vlera e dëmit të shkaktuar është 768,15€.

Me datë 06.12.2014 rreth orës 13:50 në pyllin shoqëror në Njësinë Menaxhuese “L.....”, në vendin e quajtur “Brod”, me qëllim të përfitimit pasurorë në mënyr të kundërligjshme për vete apo personit tjetër, me sharrë motorike ka prerë katër copë dru të llojit “Ahu” me gjatësi prej 16-17m, me diametër 43-30cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.60m<sup>3</sup>, e kishte ngarkuar me traktor, dhe ishte larguar nga aty, me të cilin veprim ka dëmtuar DBPZHR në Ferizaj në vlerë prej 351.00 €.

Me datë 30.09.2015 në orën 16:45 në rajonin pyjor në Brod, në pyllin shtetëror, në vendin e quajtur “Paralelja nr3”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë për vete apo personit tjetër, është takuar nga roja e pyllit duke transportuar me traktor drunjtë të pa damkosur dhe pa dokumentacion përkatës sasinë prej 2,08m<sup>3</sup>, të cilët paraprakisht me motosharrë i kishte prerë, me të cilin veprim ka dëmtuar Drejtorin për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë në vlerë prej 280,80€(Dyqindë e tetëdhjetë euro, e tetëdhjet cent).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjyqtari gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 dhe vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së,për çka të njëjtin e ka shpallë fajtor dhe i ka shqiptuar dënim unik për të gjitha veprat penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana

lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tij për të gjitha veprat penale për të cilat është akuzuar sipas aktakuzave të lartcekura, sjelljen e tij korrekte në procedurën penale, rrethanat familjare të tij, faktin se i njëjti jeton vetëm me babain e tij të moshës së shtyrë dhe me probleme shëndetësore si dhe atë se nuk ka burim tjetër të të ardhurave për egzistencë. Andaj në bazë të këtyre rrethanave gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprave të cilat i njëjti i ka kryer dhe pas këtij vlerësimi të akuzuarit i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej 300 €uro të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit dhe i vërteton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 5 muajve të cilin dënim me pëlqimin e tij, e konform nenit 48 par.1 të KPRK-së ia ka zëvendësuar me punë në dobi të përgjithshme dhe atë duke e obliguar që të kryej 240 orë punë në dobi të përgjithshme, e të cilën punë duhet ta kryej brenda 6 (gjashtë) muajshë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se dënimi tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprave konkrete penale, rrethanave të kryerjes së tyre si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale që i akuzuarit të mos kryej vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të këtyre veprave penale në shoqëri, konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata duke u mbështetur në nenin 463 par.2 të KPRK-së ka obliguar të akuzuarin që në emër të kërkesës pasuroro-jurdike të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë - Njësia e Pylltarisë t'ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 2,467,80 €uro (dymijë e katërqindë e

gjashtëdhjet e shtatë Euro e tetëdhjetë cent), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nen. 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së gjykata të akuzuarin e ka obliguar që të paguaj paushallit gjyqësor në shumë prej 30 €, këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nga sa u theksua ma lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË  
SHTËRPCË**

**P.nr.59/2014, P.nr.34/2015, P.nr.96/2015,dhe P.nr.121/2015  
dt.18.08.2016**

**Procesbajtëse:**

**Gjyqtari**

Shkëlqesa Shabani

Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa

në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit,

Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.